

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 164/2011  
Prishtinë  
20 mars 2012

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Supreme e Kosovës** në përputhje me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 28 shkurt 2012 në Gjykatën Supreme mbajti seancë në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit, gjyqtarit të EULEX-it Horst Proetel dhe gjyqtarëve të Kosovës Emine Mustafa, Nesrin Lushta dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit,

dhe me Stephen Parkinson e Joe Hollerhead si procesmbajtës,

Në praninë e

Avokatit mbrojtës B.K. për të pandehurin N.M.,

Avokatit mbrojtës H.M. për të pandehurin R.S.,

Avokatit X.H. si përfaqësues ligjor i palës së dëmtuar

Në lëndën penale me numër AP-KZ 164/2011 kundër të pandehurve:

**N.M.**, i lindur më XXX në fshatin XXX, shqiptar i Kosovës, emri i të atit XXX emri dhe mbiemri i vajzërisë i së ëmës XXX, me vendbanim në fshatin XXX, i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, me gjendje të dobët ekonomike, nuk është i dënuar më parë, në paraburgim që nga 02 shtator 2008 deri më 17 shkurt 2010 dhe në arrest shtëpiak prej 18 shkurt 2010;

**R.S.**, i lindur më XXX në fshatin XXX, shqiptar i Kosovës, emri i të atit XXX, emri dhe mbiemri i vajzërisë i së ëmës XXX, me vendbanim në fshatin XXX, i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i papunë (invalid), me gjendje të dobët ekonomike, nuk është i dënuar më parë, nuk ka qenë nën asnjë masë të sigurisë;

Në përputhje me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në lëndën nr. P. Nr. 17/09 të datës 07 tetor 2010, **të pandehurit u shpallën fajtorë për veprat penale në vijim:**

**I pandehuri N.M.:**

[i] Sepse më 02 shtator 2008 në mëngjes kishte një konflikt në mes të pandehurve N.M. dhe R.S. në njërën anë dhe dëshmitarit R.S. në anën tjetër. T. S.habani, vëllai i R. S., i thirri të pandehurit N.M. dhe R.S. të takohen dhe ta zgjidhin kontestin. Ata e lanë takimin rreth orës 17:00 në parkingun e restorantit Elinda 2 në fshatin Polac, Komuna e Skenderajt. N.M. dhe R.S. vozisnin veturën Golf 2. T.S. dhe B.H. vozisnin veturën Opel Vectra. N.M. kishte armën TTM-57 me numër serik 863307 dhe R.S. kishte armën TTM-57 me numër serik C57818. N.M. drejton revolen e tij kah T.S.. T.S. nxori armën AK me kalibër 7.62x39 mm me numër serik 7948-1 dhe e drejtoi armën kah R.S.. R.S. lëvizi drejt T.S. dhe ia kapi pushkën T.S. Gjatë përleshjes shkrep pushka dhe R.S. qëllohet në këmbë. N.M. shtiu disa herë në T.S.. T.S. mori një plumb në anën e majtë të gjoksit të tij nga të shtënat e shkrepura nga N.M..Të dytë T.S. dhe R.S. ranë në tokë për shkak të plagëve të marra. N.M. tentoi të ikë nga vendi i ngjarjes. Gjendja e T.S.t u keqësua për shkak të dëmtimit të organeve të tij të brendshme të shkaktuara nga e shtëna në gjoks dhe vdiq po atë ditë. R.S. pësoi lëndime të rënda nga të shtënat në këmbë dhe krah. Prandaj, i pandehuri N.M. ka privuar nga jeta të ndjerin T.S.

Me këtë, i akuzuari N.M. ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprë penale të **vrasjes**, në kundërshtim me nenin 146 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK);

[ii] Sepse deri më 02 shtator 2008 ai ishte në posedim të paligjshëm të armës TTM-57 me kalibër 7.62 me numër serik 863307.

Me këtë, i akuzuari N.M. ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprë penale të **mbajtjes në pronësi, në posedim, në kontroll dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328 paragrafin 2 të KPPK-së.

**Prandaj, ai dënohet si në vijim:**

I akuzuari u dënua për veprë penale të **vrasjes** me pesë (5) vjet burgim dhe për veprë penale të **mbajtjes në pronësi, në posedim, në kontroll dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** me katër (4) vjet. Gjykata e shkallës së parë formoi një dënim unik me shtatë (7) vjet burgim në përputhje me nenin 71 paragrafin 1 dhe 2 pikat (2) të KPPK-së;

**I pandehuri R.S.:**

Sepse deri më 02 shtator 2008 ai ishte në posedim të paligjshëm të armës TTM-57 me kalibër 7.62 me numër serik C57818.

Me këtë, i pandehuri R.S. ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprë penale të **mbajtjes në pronësi, në posedim, në kontroll dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me nenin 328 paragrafin 2 të KPPK-së.

**Prandaj ai u dënua me dy (2) vjet burgim.**

Të dyja armët e lartpërmendura të pandehurve janë konfiskuar në pajtueshmëri me Nenin 60 paragrafi 1 dhe Neni 328 paragrafi 5 të KPPK. Për më tepër, të dy të pandehurit janë

dënuar për të kompensuar pjesët e tyre të shpenzimeve të procedurës penale në pajtueshmëri me Nenin 102 paragrafi 1 të KPPK-së me përjashtim të kostos për përkthim.

**Avokati mbrojtës i të pandehurit N.M.** ka ushtruar ankesë në kohë më datën 08 mars 2011 kundër aktgjykimit. Është theksuar se aktgjykimi përmban shkelje substanciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të Kodit Penal dhe dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit kundërshtohet. Është propozuar të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar për lirimin e të pandehurit nga akuza për **Vrasje** dhe për të zbutur dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit për **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe shfrytëzim të armëve.**

**Avokati mbrojtës i të pandehurit R.S.** ka ushtruar ankesë në kohë më datën 08 mars 2008 e cila u regjistrua në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 15 mars 2008. Është theksuar se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje substanciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të Ligjit Penal dhe dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duhet të ri shqyrtohet. Është propozuar të priset aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet mbrapa për rigjykim apo të ndryshohet aktgjykimi dhe në këtë mënyrë të shqiptohet një dënim më i butë ndaj të pandehurit R.S.

**Gjithashtu përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka ushtruar ankesë** në kohë, duke kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit N.M. për shkak se është shumë i butë.

**ZPSK**, me përgjigjen e datës 27 shkurt 2012 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës të njëjtën ditë erdhi në përfundimin të ri-shqyrtohet ankesa e N.M. në aspektin e mbrojtjes së nevojshme të mundshme por të refuzohen të gjitha ankesat e tjera si të pabazuara.

Bazuar në aktgjykimin me shkrim në lëndën P, Nr. 17/09 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 07 tetor 2010, ankesat e paraqitura me shkrim të avokatëve mbrojtës në emër të të pandehurit N.M. dhe R.S., përfaqësuesit të palës së dëmtuar, shkresat relevante të dosjes dhe parashtresat gojore të palëve gjatë seancës së dëgjimit më 28 shkurt 2012 së bashku me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas mbajtjes së këshillimit më 28 shkurt 2012, lëshon këtë:

## **AKTGJYKIM**

**Ankesat e avokatëve mbrojtës të ushtruar në emër të të pandehurve N.M. dhe R.S. PRANOHEN PJESËRISHT. Ankesa e ushtruar në emër të palës së dëmtuar REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

**Aktgjykimi P. Nr. 17/2009 i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i datës 7 tetor 2010, anulohet në lidhje me dënimin e N.M. për veprën penale Vrasje në kundërshtim të Nenit 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe kthehet në rigjykim.**

**Aktgjykimi modifikohet në lidhje me dënimet e mbetura. N.M. është dënuar për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328 paragrafi 2 të KPK me tri (3)**

**vjet burgim. R.S. është dënuar për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontrolle, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim të Nenit 328 paragrafi 2 të KPK me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim.**

**Aktgjykimi i shkallës së parë vërtetohet në pjesët e tij të mbetura.**

## ARSYETIMI

### Historia e Procedurës

Më 24 shkurt 2009, Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë paraqiti aktakuzën (PP. nr. 98/09) në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 20 shkurt 2009, duke e akuzuar të pandehurin N.M. me veprën penale **Vrasje**, në kundërshtim të Nenit 146 në lidhje me Nenin 23 të KPK dhe për **Mbajtje në pronësi, në kontrolle, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve** në kundërshtim të Nenit 328 paragrafi 2 të KPK dhe të pandehurin R.S. me veprën penale **Mbajtje në pronësi, në kontrolle, në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të Armëve** në kundërshtim të Nenit 328 paragrafi 2 të KPK. I pandehuri i tretë është akuzuar me Vrasje në Tentativë.

Aktakuza pjesërisht është hedhur dhe modifikuar gjatë seancës së konfirmimit më 17 shkurt 2010, por cilësimi ligjor i veprave penale të të pandehurve N.M. dhe R.S. mbetet i njëjtë.

Aktakuza e ndryshuar është konfirmuar me aktvendimin e gjyqararit për konfirmim të EULEX-it më 19 shkurt 2010.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor kanë filluar më 04, 05, 06 dhe 7 tetor 2010, kur argumentet e fundit përmbyllëse janë dëgjuar dhe pas këshillimit, aktgjykimi është dhënë gojarisht.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka marrë në pyetje të pandehurin N.M. (06 tetor 2010) përderisa i pandehuri R.S. ka zgjedhur të hesht dhe ka dëgjuar këta dëshmitar: R.S., i cili është palë e dëmtuar (04 tetor 2010), B.H., N.L.(05 tetor 2010), F.X., S.G. dhe S.S.(06 tetor 2010). Për më tepër, një numër i madh i dokumenteve janë lexuar dhe janë futur në prova: Raporti fillestar mbi Incidentin i datës 02 shtator 2008; Raporti mbi Bastisjen e Shtëpisë dhe Personave (M) i datës 02 shtator 2008, Raporti mbi Bastisjen e Shtëpisë dhe Personave (S) i datës 02 shtator; Raporti i Policit të PK SG.i datës 02 shtator 2008; Raporti mbi Inspektimin e vendit të ngjarjes të PK H.H. – me foto të bashkangjitura i datës 02 shtator 2008; Raporti i Policit të PK S.M. dhe PK V.M. i datës 03 shtator 2008; Raporti i policit B.R. i datës 03 shtator 2008; Polici L.G. – raporti i hetuesit i datës 03 shtator 2008; Polici H.H. – raporti mbi inspektimin e vendit të krimit me fotografi të bashkangjitura, i datës 05 shtator 2008; Polici K.O. – kallëzimi penal i datës 05 shtator dhe drejtorja e mjekësisë ligjore, kërkesa e sektorit të vendit të krimit pa datë; dosja e identifikimit e mjekësisë ligjore #08-094 përfshirë fotografitë, A.P. – raporti i hetuesit i datës 10 shtator 2008, R.B. – raporti i autopsisë i datës 03 shtator 2008; Dr. P.D. – raporti i autopsisë i datës 03 shtator 2008 përfshirë fotografitë e bashkangjitura; shënimet e Doktorit për të lënduarin R.S. të datës 02 shtator 2008; transkriptimi i Doktorit pa datë; H.S. – përmbajtja përshkruese e shkresave të lëndës; listimi i provave; lista e gjërave të

konfiskuara; Polici L.R. – raporti i ekzaminimit kriminal; E.K. – raporti i analizës së ekspertit përfshirë analizën e ekspertit nga Laboratori Qendror i hetimit të Krimeve (A), Ekspertiza/Analiza forma (B) nga Laboratori Qendror i Mjekësisë Ligjore; Ekspertiza/Analiza forma (A) nga Laboratori Qendror i Mjekësisë Ligjore; formulari për ekzaminim të mjekësisë ligjore në laboratorin e PK-së (A) dhe formulari për ekzaminim të mjekësisë ligjore në laboratorin e PK-së (B), pa datë; F.S. – raporti i ekzaminimit të mjekësisë ligjore, sektori i daktiloskopisë, përfshirë kërkesën për ekzaminim/analizën e provave në Laboratorin Qendror të Mjekësisë Ligjore (B) i datës 27 nëntor 2008; Polici H.S. – raporti nga inspektimi i vendit të krimit i datës 04 shtator 2010 dhe Polici F.F. – raporti i identifikimit i mjekësisë ligjore përfshirë skicën e vendit të krimit dhe foto albumi i datës 03 shtator 2008.

Në bazë të gjetjeve të saj, më 07 tetor 2010, Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin dhe ka shpallur të pandehurit fajtorë për veprat penale të përmendura më lart. Si rrjedhojë, gjykata i ka shqiptuar të pandehurve dënimet e specifikuara më lart.

**Avokati mbrojtës i të pandehurit N.M.** brenda afatit kohorë ka paraqitur ankesën e datës 08 mars 2011 kundër aktgjykimin dhe ka pohuar siç është theksuar më parë.

**Avokati mbrojtës i të pandehurit R.S.** brenda afatit kohorë ka paraqitur ankesën e datës 08 mars 2008 kundër aktgjykimin dhe ka pohuar siç është theksuar më parë.

**Përfaqësuesi i palës së dëmtuar** gjithashtu brenda afatit kohorë ka paraqitur ankesë duke kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit N.M., si shumë i ulët.

**ZPShK-ja**, me përgjigjen e datës 27 shkurt 2008 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën ditë ka përfunduar siç është cekur më parë.

Më 20 mars 2012, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën sipas nenit 410 të KPPK-së.

Avokatët mbrojtës dhe përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar kanë konfirmuar parashtrësit dhe kërkesat e tyre.

## **GJETJET E GJYKATËS**

### **A. Shkelja substanciale e dispozitave të procedurës penale**

#### **I. PAKUPTUESHMËRIA E DISPOZITIVIT NË LIDHJE ME TË PANDEHURIN N.M.:**

Mbrojtja e N.M. ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së parë sepse dispozitivi ka shkelur nenin 403 paragrafin 1 pikën 12 të KPPK-së, që nga fillimi i ngjarjes, motivimi për veprat penale të pretenduara si dhe arsyet pse i pandehuri N.M. dhe i bashkëpandehuri R.S. kanë ardhur në kontakt me të ndjerin dhe vëllain e tij nuk janë specifikuar nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata Supreme nuk e ndan mendimin e mbrojtjes siç është cekur më lart. Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar përmban të gjitha informatat e nevojshme siç kërkohet me nenin 396 paragrafët 3 dhe 4 në lidhje me nenin 391 të KPPK-së.

Gjykata Supreme në veçanti gjen se përmendja e kohës së saktë të ngjarjes, do të thotë diskutimin në mes të dy të pandehurve dhe vëllait të viktimës, R.S., në mëngjesin e 2 shtatorit 2008 nuk është e nevojshme për dispozitivin në fjalë. Në mënyrë plotësisht të mjaftueshme, dispozitivi i referohet fillimit të ngjarjes kriminale në parkingun e “Restorantit Elinda 2” në Polac rreth orës 17:00.

Gjykata Supreme gjithashtu gjen se neni 146 i KPK-së, për të cilin i pandehuri N.M. është shpallur fajtor, për dallim në disa raste i referuar në nenin 147 të KPK-së nuk kërkon motiv të caktuar përveç kushteve të rregullta subjektive të dashjes së kryerësit.

Prandaj, sa i përket të pandehurit N.M., dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar konsiderohet në pajtim me ligjin.

## **II. PAMJAFTUESHMËRIA DHE MOSPËRPUTHJA E ARSYETIMIT NË LIDHJE ME TË PANDEHURIN RS.:**

Avokati mbrojtës i të pandehurit R.S. ka theksuar se arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar në lidhje me klientin e tij nuk është i qartë dhe për më tepër nuk përket me realitetin. Gjykata e shkallës së parë në veçanti nuk ka marrë parasysh deklaratat e dëshmitarëve N.L., F.X. dhe S.G., sipas të cilave R.S. nuk ka pasur fare armë në dorë gjatë periudhës kohore diskutabile.

Gjykata Supreme gjen se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar përmbush të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 396 paragrafët 3 dhe 4 në lidhje me nenin 391 të KPPK-së. Dispozitivi-edhe pse mjaft i shkurtër – është gjithashtu i qartë përtej çdo dyshimi në lidhje me faktet vendimtare dhe aktin kriminal për të cilin i pandehuri R.S. është shpallur fajtor.

Në kontekstin e dhënë gjithashtu duhet nënvizuar se-përkundër asaj që mbrojtja beson – gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë ka marrë parasysh deklaratat e dëshmitarëve, vërejtjet e të cilëve do të mund të kuptoheshin në dobi të të akuzuarit. Trupi gjykues në veçanti i është referuar dëshmitarëve N.L. dhe S.G., siç mund të kuptohet nga aktgjykimi i kundërshtuar (f.23 e versionit në gjuhën angleze). Pyetja, nëse Gjykata ka vlerësuar në mënyrë të saktë dhe plotësisht të gjitha provat e pranueshme, nuk është temë diskutimi në dispozitiv.

### **B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike**

#### **I. VËRTETIMI I FAKTEVE LIDHUR ME TË PANDEHURIN NM.:**

Avokati mbrojtës i të pandehurit N.M. ka kundërshtuar Aktgjykimin e shkallës së parë, sepse arsyetimi i tij nuk përmban asnjë dëshmi lidhur me temën e diskutimit të zhvilluar në mes të R.S.t dhe të pandehurve N.M. dhe R.S. në zyrën e këtyre të fundit si dhe për çfarë është diskutuar në këtë drejtim në mes të R.S.t dhe vëllait të tij, të ndjerit T.S. dhe nipit të R.S., dëshmitarit

B.H. Përkundër kësaj, Gjykata e shkallës së parë nuk kishte marrë parasysh dëshmitë e personave të cilët kanë qenë të pranishëm në vendin e krimit kur policia kishte shkuar atje. Gjykatës po ashtu nuk iu afrua as ekspertiza e saktë lidhur me atë se sa plumba ishin gjetur në vendin e krimit dhe nga cilat armë ishin shkrepur ata.

Gjykata Supreme konstaton se pretendimet e mbrojtjes lidhur me temat e diskutimeve në mes të R.S. dhe të pandehurve N.M. dhe R.G. në zyrën e këtij të fundit nuk kanë rëndësi të madhe për veprën penale në fjalë dhe se për këtë arsye nuk ka nevojë të vërtetohen këto fakte si fakte vendimtare për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor N.M.

Përderisa e njëjta gjë vlen edhe për përmbajtjen e diskutimeve në mes të R.S. dhe vëllait të tij, tash të ndjerit T.S., së paku sa i përket përgjegjësisë penale të N.M., Gjykata Supreme është vërtetë e shqetësuar lidhur me vlerësimin e provave të trupit gjykues lidhur me të shtënat dhe vrasjen e T.S.

Edhe pse nuk pajtohem me mendimin e mbrojtjes se numri i plumbave të gjetur në vendin e krimit është i paqartë, duhet patjetër të konstatohet se nuk është mbyllur zinxhiri i provave lidhur me atë nëse i pandehuri N.M. e ka vlarë të ndjerin T.S. apo jo. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti që sipas protokolleve të policisë dhe raportit të balistikës, në vendin e krimit janë gjetur këto armë dhe municione apo gëzhoja të municioneve:

- 1 pushkë gjysmë automatike me numër serik AK 5748
- 2 revole të markës Crvena Zastava TTM - 57, njëra prej tyre me numrin 863307 të gërryer me dorë, ndërsa tjetra me numër serik industrial C57818
- 18 plumba të kalibrit 7.62 x 39 mm
- 7 gëzhoja të kalibrit 7.62 x 25 mm

Përderisa nuk kontestohet fakti se pushka gjysmë automatike është përdorur nga i ndjeri T.S. ashtu sikur edhe fakti se municioni i kalibrit 7.62 x 39 mm i përket këtij lloji të armës, kurrë nuk është vërtetuar se me çfarë lloji të municionit (të kalibrit 7.62 x 25 mm apo të kalibrit 7.62 x 39 mm) është shkaktuar vdekja e të ndjerit T.S.t.

Për më tepër Aktgjykimi i kundërshtuar e përmend qartë raportin balistik, sipas të cilit vetëm katër prej gjithsej shtatë gëzhojave të zbrazëta të kalibrit 7.62 x 25 mm janë shkrepur nga arma TTM – 57 me numrin e gdhendur me dorë 863307, armë kjo e të pandehurit NM., përderisa me të njëjtin raport balistik vërtetohet pozitivisht se tri gëzhojat e tjera të kalibrit 7.62 x 25 mm nuk janë shkrepur nga njëra prej dy revoleve të gjetura në vendin e krimit, as nga arma e të pandehurit NM., as nga revolja tjetër TTM-57 me numër personal C57818. Për këtë arsye, Gjykata e shkallës së parë nuk e provon lidhjen shkakore në mes të shtënave të shkrepura nga NM. dhe të vdekjes së T.S.t.

Gjykata Supreme, për këtë qëllim, konstaton se për shkak të këtyre arsyeve të përmendura më lart e po ashtu edhe për shkak të vetë deklaratave të dëshmitarit B.H., nipit të të ndjerit T.S., të cilën deklaratë e ka bërë para policisë më 2 shtator 2008 dhe para gjykatës më 5 tetor 2010, këto deklarata duhet të merren parasysh edhe një herë, sipas të cilave në kohën e arritjes së tyre në parkingun në fjalë, aty veç kishin qenë të parkuara dy vetura dhe katër deri në gjashtë persona ishin duke e pritur T.S.n, në mesin e të cilëve edhe të dy të pandehurit e këtij rasti. Përderisa Gjykata e shkallës së parë ka bërë “copy – paste” të dëshmive në polici të dhëna nga dëshmitari B.H. më datën 2 shtator 2008, duke i kopjuar të

njëjtat dhe pastaj duke i futur ato në arsyetimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, duke marrë kështu pothuaj një faqe e gjysmë të arsyetimit në fjalë. Ky aktgjykim nuk përmban asnjë vlerësim, për çfarë arsye (gjoja) Gjykata e Qarkut nuk ka ndjekur dëshmitë e dëshmitarëve, të cilat janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, siç pasqyrohet në arsyetimin e aktgjykimit. Dëshmia e dëshmitarit B.H. ashtu siç është dhënë para gjykatës më 5 tetor 2010 nuk është pasqyruar fare në arsyetimin e Aktgjykimit të kundërshtuar, ndërsa nuk përmendet fare as dëshmia e dhënë nga i pandehuri R.S. jashtë shqyrtimit gjyqësor.

## II. VËRTETIMI I FAKTEVE LIDHUR ME TË PANDEHURIN R.S.:

Mbrojtja e R.S. ka theksuar mendimin e tyre se Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë provë rreth asaj se veprimet e të pandehurit R.S. ndonjëherë kanë krijuar elemente të veprës penale për të cilën është akuzuar i njëjti. Për më tepër, nuk janë vërtetuar madje as ora, as vendi as mënyra e kryerjes së veprës.

Gjykata Supreme konstaton se pohimi i mbrojtjes është jomeritor, edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë përmban disa dobësi lidhur me krahasimin e dëshmive kundërshtuese të dëshmitarëve dhe vlerësimin nëse dëshmitarët në fjalë janë të besueshëm apo jo. Megjithatë, gjykata ka bërë vlerësimin e dëshmive përkatëse dhe ka ardhur në përfundimin se revolja TTM - 57, me numrin serik C57818 ka qenë në dorë të të pandehurit R.S. para se i njëjti të binte përtokë. Me qëllim të shmangies së përsëritjeve të panevojshme, i referohemi arsyetimit të Aktgjykimit të kundërshtuar (faqe 23 e versionit në gjuhën angleze), i cili duket se është plotësisht i mjaftueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka bazuar mendimin e saj në këtë aspekt në provat e pranueshme të cilat kanë qenë në dispozicion të trupit gjykues.

E fundit por jo më pak e rëndësishme është fakti që duhet të përmendet se dëshmitari dhe pala e dëmtuar R.S. ka dëshmuar se të dy të pandehurit si N.M. ashtu edhe R.S., rregullisht kanë mbajtur armë me vete pa ndonjë autorizim përkatës.

### C. Shkelja substanciale e ligjit penal

Të dy avokatët mbrojtës, secili prej klientëve të tij përkatës, kanë theksuar që kualifikimi gjyqësor për veprat penale të të pandehurve që janë shpallur fajtorë (në përjashtim të veprës penale **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, e cila është pranuar nga N.M.) nuk është bazuar në provat materiale.

Referencë i është bërë asaj që është vërtetuar nën pikën B të aktgjykimit në fjalë. Përderisa Gjykata Supreme nuk gjen asnjë lëshim të gjykatës së shkallës së parë lidhur me të pandehurin R.S. që është shpallur fajtor për **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, vlerësimi i provave lidhur me përgjegjësinë penale të pandehurit N.M. për vrasjen e T.S. nuk është i mjaftueshëm për mbylljen e zinxhirit të dëshmive dhe të vërtetoj ndonjë lidhje shkakore në mes të shtënës së të pandehurit dhe vdekjes së të ndjerit T.S. Kështu që, për momentin dhe me provat e vërtetuara, situata nuk mund të cilësohet si Vrasje në pajtim me nenin 146 të KPK-së.



## D. Vendimi mbi dënimin

### I. DËNIMI I SHQIPTUAR NDA TË PANDEHURIT N.M.:

Përderisa avokati mbrojtës i të pandehurit N.M. është i mendimit që dënimi i shqiptuar ndaj të mbrojturit të tij është shumë i ashpër duke pasur parasysh që Vrasja e pretenduar nuk është dëshmuar dhe i pandehuri e kishte armën vetëm si suvenir nga lufta, përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka atakuar aktgjykimin e shkallës së parë si shumë të butë lidhur me dënimin për **Vrasje**, duke marr parasysh që pesë vite janë dënimi minimal i paraparë me ligj dhe që i vdekuri ishte bashkëshort dhe baba i tetë (8) fëmijëve dhe që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë e tij.

Referencë i është bërë asaj që është vërtetuar nën pikën B të aktgjyimit në fjalë. Dënimi që duhet të shqiptohet të pandehurit N.M. duhet të merret parasysh përsëri bazuar në të gjeturat e gjyimit të serishëm, pasi që të sqarohet përgjegjësia apo papërgjegjësia lidhur me vrasjen e T.S. Prandaj, dënimi unik i shqiptuar ndaj N.M. nuk mund të vërtetohet.

Megjithatë, pasi që i pandehuri N.M. ka pranuar veprën penale të **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve** në kundërshtim të nenit 328, paragrafit 2 të KPK-së, dënimi i veçantë siç është shqiptuar nga Gjykata e Qarkut duhet të konsiderohet përsëri. Duke pasur parasysh që fokusi i aktiviteteve penale në lëndën në fjalë është në vrasjen e të vdekurit T.S., Gjykata Supreme është e mendimit që dënimet e veçanta siç janë shqiptuar nga Gjykata e Qarkut ndaj të pandehurit N.M. për **Vrasjen** e pretenduar dhe **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim ose në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve** nuk janë mirë të ekuilibruara në lidhje me njëra tjetrën, e cila është arsyeja që dënimi për veprën e mëvonshme penale duhet të zvogëlohet. Duke e konsideruar si rrethanë rënduese faktin që N.M. ishte duke vepruar si person zyrtar dhe oficer komandues i Forcave të Kosovës, kështu duke përdorur armën ilegale për zgjidhjen e kontestit privat, dënimi i ndarë ishte zvogëluar me tri (3) vite burgim.

## II. DËNIMI I SHQIPTUAR NDAJ TË PANDEHURIT R.S.:

Mbrojtja e R.S. përfundimisht është e mendimit që dënimi i shqiptuar do të ishte shumë i rëndë dhe jo proporcional me veprimet inkriminuese.

Referencë i është bërë asaj që tashmë është deklaruar në kontekst të dënimit ndaj N.M. Si rrethanë rënduese është e nevojshme të merret parasysh që R.S. gjithashtu ishte duke vepruar si person zyrtar dhe oficer komandues i Forcave të Kosovës, kështu përdorimi i armës ilegale për të zgjidhur kontestin privat. Në dobi të tij duhet të merret parasysh fakti që arma e gjetur tek ai afër dorës së djathtë të tij ishte e zbrazët dhe nga koj armë nuk është shtënë në drejtim të incidentit në fjalë.

Prandaj, në lidhje me dënimin siç i është shqiptuar N.M. dënimi ndaj R.S. është zvogëluar në 1.5 vite burgim.

Në të dyja rastet gjithashtu është marr parasysh niveli i rrezikut shoqëror i kryerjes së veprave penale sikurse këto në fjalë e gjithashtu edhe niveli i përgjegjësisë së të pandehurve.

Për arsytet të lartpërmendura, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv.

### **Anëtarët e kolegjit:**

---

Dr. Horst Proetel  
Gjyqtar i EULEX-it

---

Avdi Dinaj  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

---

Nesrin Lushta  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Emine Mustafa  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

### **Kryetar i kolegjit:**

Procesmbajtës

---

Gerrit-Marc Sprenger  
Gjyqtar i EULEX-it

---

Holger Engelmann  
Zyrtar Ligjor i EULEX-it

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**Ap.-Kž. nr. 164/2011**  
**Prishtinë**  
**20 mars 2012**